



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr.129/9 Prot.

Tiranë, më 27/05/2016

V E N D I M

Nr.56, Datë 27/05/2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË ELBASAN "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Elbasan, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Në Bashkinë Elbasan, nga auditimi i mëparshëm, janë rekomanduar nga KLSH detyra për tu zbatuar sipas shkresës me nr. 307/7, datë 30.6.2014.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve, është audituar sipas programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1128/2, datë 03.12.2014 për të cilin është mbajtur akti i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nr. 1, datë 29.12.2014. Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna, u konstatua:

Nga 10 masa organizative të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 7 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 1 masë organizative nuk është zbatuar.

Nga 14 masa për shpërblimin e dëmit në vlerën 30,847,525 lekë, gjatë periudhës së auditimit u zbatuan 2 masa duke arkëtuar vlerën 501.023 lekë. Janë në proces zbatimi 12 masa për arkëtimin e vlerës së mbetur për 30,346,502 lekë. Janë ndjekur procedurat administrative për arkëtimin e dëmit; titullari i bashkisë ka nxjerrë urdhrat e zhdëmtimit, janë njoftuar subjektet debitorë një pjesë e të cilëve, kanë bërë padi në Gjykatë për kundërshtim të urdhër zhdëmtimit, kurse nga Bashkia Elbasan, nuk janë bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë për arkëtimin e vlerës së dëmit.

Nga 13 masa disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar të gjitha.

1.1. Rekomandimi:

Të merren masa për realizimin e detyrave të pa realizuara sipas rekomandimeve të dërguara me shkresën nr. 307/7, datë 30.6.2014, të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Elbasan, ka në juridiksionin e vet 12 njësi administrative (ish-komuna), të krijuara sipas ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Në rregulloren e funksionimit të brendshëm të bashkisë, nuk janë parashikuar rregulla dhe detyra për administratorët e njësive administrative dhe për punonjësit e tjerë të përfshirë në to.

2.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masa për rishikimin e rregullores së funksionimit të brendshëm, me qëllim përcaktimin e detyrave dhe kompetencave të qarta për çdo njësi organizative në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë, 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”.

Brenda Muajit Shtator 2016

3. Gjetje nga auditimi:

Për vitet 2014 dhe 2015, programimi i buxheteve të Bashkisë Elbasan, është përgatitur në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse.

Është bërë ndarja e plan buxheteve sipas strukturës. Çelja e fondeve është respektuar sipas detajimeve të bëra në fillim të çdo viti ushtrimor. Shpenzimet operative janë ndjekur sipas nën artikujve gjatë zbatimit të buxhetit. Nga dega e Thesarit janë çelur fondet rast pas rasti sa herë që është krijuar gjendje nga të ardhurat.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 8, datë 27.02.2015 “Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm 2016-2018” si dhe udhëzimin nr. 7/1, datë 28.02.2014, është përgatitur Projekt-buxheti afatmesëm 2016-2018.

Buxhetet, janë miratuar me vendime të këshillit të bashkisë, jashtë afateve ligjorë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Për vitin 2014, të ardhurat e programuara janë 2,928,139 mijë lekë nga të cilat 426,372 mijë lekë janë të ardhura nga kredia, janë realizuar në fakt gjithsej 2,467,144 mijë lekë ose 85 %, nga të cilat 315,829 mijë lekë janë të ardhura nga kredia.

Realizimi i buxhetit, për vitin 2014, programuar 2,928,130 mijë lekë, realizuar 2,407,515 mijë lekë ose 82%.

Janë paguar sipas vendimeve gjyqësore 27,644,361 lekë për 5 vendime gjyqësore të zhvilluara para viti 2012, nga këto; 22,000,000 lekë ndaj subjektit V.I. detyrim i lindur në vitin 2012.

Për vitin 2015, të ardhurat e programuara janë 3,141,312 mijë lekë nga të cilat 247,584 mijë lekë janë të ardhura nga kredia, janë realizuar në fakt gjithsej 2,727,204 mijë lekë ose 87%, nga të cilat 101,329 mijë lekë janë të ardhura nga kredia.

Realizimi i buxhetit, për vitin 2015, programuar 3,141,312 mijë lekë, realizuar 2,458,455 mijë lekë ose 78%.

Janë paguar detyrime të prapambetura për vlerën 121,511,630 lekë, ndërkohë që janë pa paguar detyrime të tjera në vlerën 74,721,020 lekë që iu përkasin detyrime ndaj 21 subjekteve.

Gjatë auditimit të detyrimeve të pa likuiduara e që trashëgohen për vitin 2016, rezultojnë gjithsej 141,281,442 lekë nga të cilat shpenzime operative 39,069,261 lekë dhe për investime 102,218,181 lekë.

3.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masa për përgatitjen e buxheteve sa më realë, me qëllim të ulë në ecuri detyrimet e pa paguara e të trashëguara nga vitet paraardhëse.

Të ndjekë në kohe detyrimet kontraktuale, dhe përgjithësisht marrëdhëniet me të tretët, pasi shumat e paguara në vitin 2014 sipas vendimeve gjyqësore, kanë përkeqësuar treguesit financiarë të bashkisë dhe për rrjedhojë edhe detyrimet ndaj të tretëve që trashëgohen për vitin 2016, janë të konsiderueshme.

Në vijueshmëri

4. Gjetje nga auditimi:

Në Bashkinë Elbasan, u konstatuan parregullsi në evidentimin e konsumit të karburantit. Në disa raste, në fletët e udhëtimit, nuk është plotësuar qartë destinacioni i lëvizjes të automjetit dhe nuk janë shënuar km rrugë të përshkruara duke pa mundur evidentimin e konsumit të karburantit sipas normativave të miratuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 36, 37, 42, 43, 44.

4.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masa për evidentimin e konsumit të karburantit me dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor, njëkohësisht duke nxjerr përgjegjësitë përkatëse ndaj personave përgjegjës.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi:

Drejtori e Financës të Bashkisë Elbasan, nuk ka proceduar në kohë për shkarkimi nga kontabiliteti të vlerave inventariale për rastet kur pas procedurave të inventarizimit, janë nxjerrë jashtë përdorimit inventarë me procesverbale asgjësimi.

Në vitin 2013 janë nxjerrë jashtë përdorimit inventarë në vlerën 567,848 lekë, kurse kontabiliteti është shkarkuar për këtë vlerë në vitin 2014.

Në vitin 2014 janë nxjerrë jashtë përdorimit inventarë në vlerën 313,316 lekë, kurse kontabiliteti është shkarkuar për këtë vlerë në vitin 2014.

Kjo praktikë, nuk pasqyron me vërtetësi në kohë gjendjen e aktiveve të Institucionit të Bashkia Elbasan, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 106, 107, 108, 109.

5.1. Rekomandimi:

Drejtorja e Financës, të zbatojë të gjitha procedurat ligjore për shkarkimin në kohë nga

evidenca kontabile të aktiveve që dalin jashtë përdorimit sipas procedurave të rregullta ligjore, në të kundërt, praktika e ndjekur deri tani, lë shteg për abuzime në administrimin e aseteve.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi:

Nga të dhënat e pasqyrave financiare që ka përgatitur Drejtoria e Buxhet-Financë të bashkisë Elbasan për vitin 2014, është konstatuar se llogaria 202 “Studime ose kërkime”, pasqyron në debi të saj vlerën 43,741,328 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se disa studime e projekte në vlerën 6,731,000 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara, konkretisht:

Studim projektimi, sistemim rruga: “28 Nëntori, klinika dentare, sigurimet shoqëror” për vlerën 295,000 lekë, studim projektimi “Sistemimi i Rrugës Kozma Naska” për vlerën 195,000 lekë, studim projektimi, sistemimi i rrugës “Mahmund Biçaku” për vlerën 195,000 lekë, studim projektimi, sistemimi i rrugës “Ibrahim Dinçi” për vlerën 280,000 lekë, studim projektimi, të rrugës “Ruga e re” për vlerën 185.000 lekë, studim projektimi, KUZ nr. 14 lagja “Skënderbe” për vlerën 200.000 lekë, studim projektimi, për rrjetin KUZ, lagja “5 Maj” për vlerën 474,000 lekë dhe studimi i kalasë së Elbasanit për vlerën 4,907,000 lekë.

Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”.

6.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Buxhet-Financës, të zbatojë procedurat ligjore për sistemimin e vlerës prej 6,731.000 lekë të kontabilizuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda vitit 2016

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pasqyrave financiare të njësisë administrative të Bashkisë Elbasan, (ish komuna), për aktivitetin e periudhës 01.01.2015 deri më 07.07.2015, u konstatuan raste të pasqyrit jo të saktë të gjendjeve të aktiveve.

Për njësinë administrative **Papër:**

Llogaria 202 “Studime e Kërkime” rezulton me gjendje debitore për vlerën 3,370,738 lekë, nga të cilat vlera 3,040,738 lekë, u përket objekteve të përfunduara:

-140,000 lekë projekti “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Broshkës”, përfunduar në vitin 2007,

-60,000 lekë projekti: “Rrugë e arave Vidhas”, përfunduar në vitin 2017,

-70,000 lekë projekti: “Rrugë të brendshme fshati Broshkë”, përfunduar në vitin 2008,

-60,000 lekë projekti: “Rikonstruksion dhe asfaltim fshati Lugaj” përfunduar në vitin 2008,

-200,000 lekë projekti: “Rikonstruksion dhe asfaltim fshati Ullishtaj” përfunduar në vitin 2008,

-200,000 lekë projekti: “Rikonstruksion dhe asfaltim fshati Valas, Ura Vidhas, Depo Uji Bizhutë”, përfunduar në vitin 2009,

-250,000 lekë projekti: “Ndërtim zonë kreative, lulishte Papër”, përfunduar në vitin 2011.

Vlera e këtyre objekteve, duhet të sistemohet në vlerën e investimit të përfunduar.

Për disa llogari të pasqyrave financiare, vlerat kontabël, nuk janë të njëjta me vlerën e gjendjes fizike të aktiveve sipas rezultateve të inventarizimit:

-**Llogaria 215** “Mjete transporti” rezulton me vlerë debie 4,671,900 lekë kurse gjendja fizike është në vlerën 4,273,300 lekë, pra gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël.

Llogaria 327, objekte inventari me vlerë të debisë për 8,543,453 lekë nga 14,984,158 lekë që është gjendja fizike e këtyre inventarëve.

Për diferencat si më sipër, nga njësia administrative Papër, janë paraqitur në Bashkinë Elbasan, vendimet e këshillit të kësaj ish komune mbi miratimin për nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarëve sipas propozimeve të komisioneve të inventarizimit të kryera në vitet 2008-2014, duke pretenduar se për këto raste nuk janë bërë veprime kontabël në llogaritë përkatëse.

Llogaria 215 “Mjetet transporti”, rezulton me gjendje fizike më tepër se sa vlera e debisë të kësaj llogarie, për vlerën 398.600 lekë.

-Për njësinë administrative **Bradashesh**.

Llogaria 327 “Objekt inventar”, në debi të kësaj llogarie, është kontabilizuar vlera 210,000 lekë, që përfaqësojnë inventarë ekonomik dhe duhej të ishte kontabilizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

-Për njësinë administrative **Bradashesh**.

Llogari 215 “Mjete transporti” rezulton me gjendje fizike më tepër se sa vlera e debisë të kësaj llogarie (gjendja kontabël) për vlerën 25,634,360 lekë.

-Për njësinë administrative **Labinot Mal**.

Llogari 215 “Mjete transporti” rezulton me gjendje fizike më tepër se sa gjendja kontabël për vlerën 7,219,600 lekë.

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, me vlerën debitore 2,105,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e studimeve dhe projekteve të aktiveve të qëndrueshme të përfunduara në vite. Vlera debitore e kësaj llogarie, duhej të transferohej në debi të llogarive të aktiveve të investuara dhe të regjistruara në kontabilitet.

-Për njësinë administrative **Shirgjan**.

Llogaria 218, “Inventari ekonomik”, rezulton me gjendje kontabël në vlerën 12,239,663 lekë kurse gjendja fizike sipas kartelave inventariale të dorëzuara në Drejtorinë e Financës të Bashkisë Elbasan, është 11,485,148 lekë ose më pak për vlerën 754,518 lekë.

Llogaria 327 “Objekte inventari” në bilanc paraqitet me vlerë 4,27,567 lekë ndërkohë që në inventarin e marrë në dorëzim nga grupi i punës së ngritur nga Bashkia Elbasan në zbatim të VKM nr. 510, datë 8.06.2015, rezulton në vlerën 3,763,173 lekë ose më pak për 35,394 lekë. Në total për këto dy llogari, inventari ekonomik dhe objektet e inventarit, rezultojnë me mungesa në gjendjen fizike për shumën 1289,912 lekë.

-Për njësinë administrative **Gjergjan**.

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, paraqitet në aktiv të bilancit vlerën 1,877,985 lekë e cila përfaqëson vlerën e studimeve e projekteve për 5 projekte, të cilat rezultojnë të financuara nga kjo ish komunë.

Në këto kushte, duhet bërë sistemimi i kësaj llogarie duke kaluar shumat përkatëse në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të investuara dhe të përfunduara.

Sipas dokumenteve që paraqiten nga Drejtoria e Financës së Bashkisë Elbasan, bazuar në bilancin e ish Komunës dhe inventarin e kryer, rezultojnë diferenca në vlerën kontabile të llogarisë 218. Në bilanc kjo llogari paraqitet për vlerën 713,700 lekë ndërkohë që nuk është kontabilizuar vlera 2,860,664 lekë për sa është konstatuar gjendje fizike nga komisioni i Bashkisë Elbasan.

Këto veprime bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” dhe UMF

nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika, 87, 88, 89.

7.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masat dhe të ngrejë grup pune për të analizuar rastet e diferencave të konstatuara sipas të dhënave të pasqyrave financiare të njësive administrative, krahasuar me gjendjen fizike të aktiveve sipas rezultateve të inventarizimeve.

Të analizohen rastet duke bërë sistemimet e nevojshme në pasqyrat financiare në zbatim të procedurave ligjore.

Për rastet të diferencave, kur vlerat kontabël janë më të mëdha se sa vlera sipas inventarizimeve fizikë, të verifikohen ato deri në origjinën e veprimeve kontabël me synim, për të konkluduar nëse ka shpërdorime të aseteve me dëm ekonomik duke nxjerr përgjegjësitë përkatëse.

Brenda Muajit Shtator 2016

8. Gjetjet nga auditimi:

Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Elbasan, gjendja e debitorëve, llogaria 468 “Debitorë të tjerë”, paraqitet më një teprice debitorë në *shumën 36,041,031 lekë*, nga të cilat 33,714,563 lekë përfaqësojnë debitorë të rekomanduara nga auditimet e KLSH-së në vite por ende të pa arkëtuar:

Auditimi në vitin 2009 për 7 subjekte në vlerën 1,080,158 lekë,

Auditimi në vitin 2010 për 20 subjekte në vlerën 2,727,097 lekë,

Auditimi në vitin 2011 për 1 subjekt në vlerën 204,200 lekë,

Auditimi në vitin 2012 për 1 subjekt në vlerën 45,250 lekë,

Auditime në vitin 2014 për vlerën 29,657,858.

Nga Bashkia Elbasan, nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit për sa këto subjekte janë nxjerr debitorë duke ndikuar në përkeqësimin e tregueseve financiarë të bashkisë.

8.1. Rekomandimi :

Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës me Drejtorinë Juridike të marr masa, të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimi i shumës së mësipërme nga subjektet dhe personat debitor të mësipërm.

Brenda vitit 2016

9. Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2014, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Elbasan, janë programuar në shumën 604,693 mijë lekë, realizuar 321,951 mijë lekë ose 53.2%, më pak për 282,742 mijë lekë.

Janë 629 subjekte debitorë të biznesit të vogël të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore për taksat dhe tarifat vendore në shumën 7,950,897 lekë nga të cilat penaliteti është 1,570,290 lekë.

Janë 140 subjekte debitorë të biznesit të madh të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në shumën 44,022,950 lekë nga të cilat penaliteti është 8,996,582 leke.

Taksat dhe tarifat nga familjarët, janë programuar për shumën 67,200 mijë lekë, janë realizuar 55,006 mijë lekë ose 81.9 %, të cilat janë mbledhur nga agjenti tatimor “Elber” Shpk.

Për vitin 2015, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, janë programuar në shumën 632,632 mijë lekë, realizuar 411,152 mijë lekë ose 65%, më pak për 221,480 mijë lekë.

Janë 588 subjekte debitorë të biznesit të vogël të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në shumën 10,891,441 lekë nga të cilat penaliteti llogaritet 1,678,261 lekë.

Janë 131 subjekte debitorë të biznesit të madh të cilët nuk kanë paguar detyrimet taksat dhe tarifatat vendore në shumën 54,734,680 lekë nga të cilat penaliteti llogaritet 10,878,517 leke. Taksat dhe tarifatat nga familjarët, janë programuar për shumën 67,200 mijë lekë, janë realizuar 56,840 mijë lekë ose 84.6 % të cilat janë mbledhur nga agjenti tatimor “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” Sh.a.

9.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore, me qëllim rritjen e performancës në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

Për vitin 2016 e në vazhdim, të merren masat e nevojshme për vjeljen e taksave dhe tarifave edhe në 12 njësitë administrative (ish-Komuna), përfshi taksën mbi pronësinë e tokës bujqësore, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Drejtori e Tatim Taksave, nuk ka krijuar të dhënat e nevojshme për vjeljen e detyrimeve për taksat lokale në 12 njësitë administrative;

Nuk janë krijuar regjistrat përkatës për taksat për biznesin, taksat familjare, taksat për ndërtesën e banimit, taksat mbi pasurinë mbi tokën bujqësore etj., në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

10.1. Rekomandimi:

Drejtori e Tatim Taksave, në bashkëpunim me administratorët e njësive, të marrë masat për krijimin e bazës të dhënave për vjeljen e taksave lokale në 12 njësitë administrative të Bashkisë Elbasan në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda Muajit Qershor 2016

11. Gjetje nga auditimi:

Me VKM nr. 416, datë 11.7.2007 “Për miratimin e listës pronave të pa luajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan të Qarkut Elbasan”, i ndryshuar me VKM nr. 593, datë 29.8.2012, është miratuar lista e pronave që kanë kaluar në përdorim dhe pronësi të Bashkisë Elbasan.

Nga Drejtoria e Administrimit të aseteve, nuk është bërë inventarizimi i këtyre pronave mbi statusin juridik aktual të tyre dhe nuk është bërë regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Elbasan, **në kundërshtim** me kërkesat e ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” DHE UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

11.1. Rekomandimi:

Nga Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, të merren masat e nevojshme për inventarizimin dhe regjistrimin në ZVRPP të pronave të bashkisë me qëllim vënien e tyre në përdorim të komunitetit në zbatim të kërkesave ligjore.

12. Gjetje nga auditimi:

Sipas të dhënave të administratorëve të 12 njësive, për 11 prej tyre, me vendime të Këshillit të Ministrave, janë miratuar listat e pronave në përdorim ose në pronësi të ish njësive të pushtetit vendor si vijon:

Për njësinë administrative **Zavalinë**; me VKM nr. 179, datë 13.2.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në përdorim.

Për njësinë administrative **Gjergjan**; me VKM nr. 113, datë 21.8.2013, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi dhe me VKM nr. 539, datë 7.8.2012, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim.

Për njësinë administrative **Papër**; me VKM nr. 376, datë 18.5.2011, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 181, datë 13.2.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në përdorim.

Për njësinë administrative **Bradashesh**; me VKM nr. 403, datë 8.4.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi dhe përdorim dhe me VKM nr. 81, datë 30.1.2013, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim.

Për njësinë administrative **Tregan**; me VKM nr. 686, datë 21.5.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi dhe me VKM nr. 457, datë 6.05.2009, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim.

Për njësinë administrative **Shushicë**; me VKM nr. 176, datë 5.3.2012, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 404, datë 8.4.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi.

Për njësinë administrative **Shirgjan**; me VKM nr. 762, datë 7.11.2012, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 684, datë 21.5.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi.

Për njësinë administrative **Gjinari**; me VKM nr. 1419, datë 10.10.2008, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 680, datë 21.05.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në përdorim.

Për njësinë administrative **Grecan**; me VKM nr. 205, datë 21.05.2008, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 690, datë 21.05.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi.

Për njësinë administrative **Funar**, me VKM nr. 772, datë 19.11.2004, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 687, datë 21.05.2008, është miratuar lista e pronave pyje dhe kullota në pronësi.

Për njësinë administrative **Labinot Fushë**, me VKM nr. 82, datë 30.01.2013, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim dhe me VKM nr. 688, datë 21.05.2008, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme në pronësi dhe në përdorim.

Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, nuk disponon të dhëna mbi gjendjen e pronave që me vendime të Këshillit të Ministrave janë miratuar në përdorim ose në pronësi të 12 njësive administrative të Bashkisë Elbasan; të dhëna mbi statusin juridik aktual të tyre, të dhëna mbi prona të cilat janë regjistruar në ZVRPP, mbi kontratat për dhënien me qira nga ish njësitet e Qeverisjes Vendore etj., në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitet e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”, kreu III, pika 1.

12.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, në bashkëpunim me IMKT-në dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat e nevojshme, për të vlerësuar statusin juridik të aseteve të cilat me

vendime të Këshillit të Ministrave, janë miratuar në përdorim ose në pronësi të ish njësive të qeverisjes vendore, me qëllim:

- marrjen e vendimeve në këshillin e bashkisë për miratimin e listës përfundimtare të pronave që janë miratuar në përdorim ose në pronësi të ish komunave sot njësi administrative.

- regjistrimin në ZVRPP të pronave të cilat janë miratuar në pronësi të njësive të qeverisjes vendore sipas miratimit me VKM dhe me vendime të ish Këshillave të Komunave, sot njësi administrative të Bashkisë Elbasan, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 9, 27, ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme”, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale” dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

- marrjen e masave për dhënien me qira të aseteve në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, kreu IV, neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin kullosor” i ndryshuar, neni 18, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 6 dhe VKM nr. 529, datë 8.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda Muajit Qershor 2016

13. Gjetje nga auditimi:

- Nga të dhënat që disponojnë administratorët e njësive, konstatohet se në 4 njësitë; Gjergjan, Papër, Bradashësh dhe Shushicë, janë lidhur nga ish titullarët e komunave gjithsej 12 kontrata për dhënien me qira të aseteve të cilat janë në pronësi ose në përdorim të njësive të qeverisjes vendore. Nga këto; 6 kontrata janë lidhur për dhënien me qira të tokës bujqësore gjithsej 42,8435 ha me afat 99 vjet dhe 6 kontrata për dhënien me qira të truallit për kompanitë celulare gjithsej 2200 m² me afat 9 vjet.

Në shumicën e rasteve, kontratat për dhënien me qira të tokës bujqësore, nuk janë lidhur në prani të një noteri, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nga Bashkia Elbasan dhe nga njësitë administrative të saj, nuk na u paraqitën kontrata të lidhura me subjektet që përdorin sipërfaqe pyjore në ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin minerar sipas lejeve të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

Nga të dhënat në Web të Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, konstatohet se deri në Shkurt të vitit 2016, në Qarkun e Elbasanit, kanë qenë efektive 23 leje për shfrytëzimin minerar.

Nga të dhënat që na u paraqitën, në njësitë administrative; Bradashësh dhe Labinot Mal, kanë ushtruar aktivitetin e tyre për shfrytëzimin minerar, (inerte argjilor dhe gëlqerore), 6 subjekte të pajisura me leje shfrytëzimi minerar duke shfrytëzuar një sipërfaqe totale 0.997 km².

Këto subjekte, nuk kanë paguar detyrimet për taksat lokale, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Nga ish komunat dhe Bashkia Elbasan, nuk janë lidhur me këto subjektet, kontrata për sipërfaqet që përdorin sipas lejes për shfrytëzimin minerar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, neni 4.

Nuk janë paguar detyrimet sipas tarifave të miratuara në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar neni 17, pika 5 dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të cilat për 1 vit për sipërfaqen 0,997 km², llogariten **43,868,000 lekë e ardhur e munguara për Bashkinë Elbasan.**

Njësitë Administrative dhe Drejtoria e Aseteve të Bashkisë Elbasan, nuk disponon të dhëna nëse sipërfaqet pyjore që shfrytëzohen për qëllime minerare, janë hequr nga fondi pyjor ose kullor i qeverisjes vendore, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, pika 5, ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar neni 17, pika 1 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”, kreu III, pika 1.

13.1. Rekomandimi:

Drejtorja e Aseteve Pronave dhe Strehimit, në bashkëpunim me IMKT-në dhe Drejtorinë Juridike:

Të ndjekë zbatimin e kontrata për dhënien me qira të aseteve nga ish njësitë e qeverisjes vendore dhe të vlerësojë vlefshmërinë juridike të kontratave me afat 99 vjet, të lidhura pa praninë e noterit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të monitorohet aktiviteti i subjekteve të cilat shfrytëzojnë pasuritë minerare në njësitë administrative Bradashesh dhe Labinoti Mal sipas lejeve të shfrytëzimit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, duke lidhur kontrata me ta për detyrimet financiare në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar neni 17, pika 5 dhe VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Menjëherë

13.2. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të marrë masa dhe ngrejë grup pune me specialistë përkatës të kadastrës dhe hartografë për të përcaktuar saktë statusin juridik të pasurive pyje, kullota dhe të tjera, të cilat përdoren nga subjektet që kanë marrë leje për shfrytëzimin minerar, me qëllim:

Përcaktimin saktë të llojit të pronës që ka marrë në përdorimin sipas sipërfaqes të përcaktuar në lejen e shfrytëzimit minerar për llogaritjen e detyrimeve financiare në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Për heqjen nga fondi pyjor të këtyre pasurive, në zbatim të kërkesave të kërkesave të ligjit nr.10304,datë 15.07.2010“Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, neni 15,pika 5.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi:

Në këtë Bashkinë Elbasan, struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor (IMKT), është organizuar sipas miratimit me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 13, datë 19.02.2015. Në këtë strukturë, nuk është parashikuar lloji i arsimit për inspektorët e kësaj njësie.

Për vitin 2015, në këtë strukturë janë punësuar 5 specialistë inspektorë dhe kryeinspektori. Nga këta, 3 inspektorë nuk janë me arsimin e duhur profesional, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar”.

14.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të rishikojë strukturën organizative duke specifikuar numrin e specialistëve me profesione sipas kërkesave të ligjit nr. 139/2015, “Për Qeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/c dhe ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

Brenda Muajit Qershor 2016

15. Gjetje nga auditimi:

Në procedurat për evidentimin e ndërtimeve pa leje dhe për vendimet e mara nga Kryeinspektori i IMTK-së, u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore në disa raste:

-Për periudhën e viteve 2014 dhe 2015, nga IMTK-ja e Bashkisë Elbasan, janë mbajtur 66 akte konstatimi për ndërtim të objekteve pa leje duke filluar; rikonstruksione, mure rrethues dhe deri në objekte me dy tre kate. Për këto konstatime; në 23 raste është vendosur masa e gjobës, për 22 raste është bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për 52 raste, është marrë vendim për prishjen e objekti pa leje.

Për 37 raste të akteve të konstatimit, 32 vendime për prishje të objekteve pa leje dhe për 18 rasteve për kallëzime penale, i janë referuar kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban” i ndryshuar.

-U konstatua se për rastet e vendosjes së masës së gjobës, përgjithësisht vlera e saj është më e vogël se sa është parashikuar në kërkesat ligjore. Në 19 raste të audituara, është vendosur masa e gjobës më pak për shumën totale **8,250,000 lekë të ardhura të munguara** për Bashkinë Elbasan.

Në 2 raste, nuk janë zbatuar procedurat ligjore nga momenti i konstatimit të shkeljes ligjore deri në përmbushjen nga subjekti të detyrimeve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban”, neni 25, pika 3, konkretisht:

Bazuar në procesverbalin e konstatimit datë 27.11.2015 “Për shkelje të kondicioneve urbanistike duke dalë 45,5 m jashtë projektit”, është marrë vendimi i Kryeinspektorit nr. 9, datë 27.11.2015 për vendosjen e masës së gjobës 1.500.000 lekë dhe për pezullimin e punimeve për afatin 60 ditor. Në këtë rast, duhej të ishte caktuar një afat 45 ditor për të aplikuar për tu pajisur me leje tjetër ndërtimi.

Bazuar në procesverbalin e konstatimit datë 3.4.2014 “Për konstatim punime ndërtimore pa leje, kthim i banesës në dyqan”, është marrë vendimi nr. 25, datë 3.4.2014 për dhënie e masës së gjobës 200,000 lekë. Në këtë rast, nuk është marrë vendim për pezullim punimesh me një afat deri 45 ditë për tu pajisur me leje për punime të kryera në ndryshim të projektit fillestar.

15.1. Rekomandimi:

Nga IMTK-ja e bashkisë, të merren masat e nevojshme, për të zbatuar saktë kërkesat ligjore në procedurat për mbrojtjen dhe kontrollin e territorit.

Të vlerësohen rastet e vendimeve për prishjen e objekteve pa leje të pa ekzekutuara dhe për rastet e kallëzimeve penale të pa filluara nga Organi i Prokurorisë, me qëllim për të rimarrë vendime me referenca të sakta të numrit dhe nenit të ligjeve në fuqi.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi:

Nga IMKT, janë marrë 52 vendime për prishjen e objekteve të konstatuara pa leje nga të cilat nuk janë ekzekutuar 7 vendime për mungesë të mjeteve të nevojshme.

16.1. Rekomandimi:

Të merren masa, të bashkëpunohet me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për të mundësuar prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar”, neni 5 germa “d”, neni 9/1 pika 2 germat “a”, “c” dhe neni 12 pika 8 germa “c”.

Brenda Muajit Qershor 2016

17. Gjetje nga auditimi:

Nuk është arkëtuar vlera e gjobave të vendosura nga IMKT-ja gjatë viteve 2014 dhe 2015 nga 11 subjekte për ndërtime pa leje në shumën **4,790,000 lekë e ardhur e munguar** për Bashkinë Elbasan.

17.1. Rekomandimi:

Nga IMKT-ja dhe Drejtoria Juridike, të merren masat e nevojshme për arkëtimin e vlerës së gjobave për 4,790,000 lekë nga 11 subjekte për ndërtime pa leje, duke proceduar sipas kërkesave ligjore me kërkesë padi në Gjykatë.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi:

Bashkia Elbasan, në kuadër të reformës së re administrative në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nga Korriku i vitit 2015, ka në administrimin e vet edhe 12 njësi administrative, ish komunat; Zavalinë, Gracen, Gjergjan, Labinot Mal, Shirgjan, Shushicë, Papër, Funarë, Labinot Fushë, Tregan, Bradashesh dhe Gjinar.

IMKT-ja e Bashkisë Elbasan, nuk disponon të dhëna mbi gjendjen e territorit në këto njësi administrative, nuk ka përpiluar programe dhe nuk ka organizuar inspektime në territorin e këtyre njësive administrative, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territoriale”, kreu III, pika 1.

Administratorët e **8 njësive administrative**; Zavalinë, Gjergjan, Grecan, Labinot Mal, Shushicë, Papër, Funarë dhe Bradashesh, nuk disponojnë dokumentacion mbi gjendjen e territorit lidhur me ndërtimet pa leje.

Nga ish komuna **Tregan**, administrimi i territorit lidhur me ndërtimet pa leje, i është deleguar Qarkut Elbasan sipas akt-marrëveshjes me nr. 209 Prot., datë 8.2.2008 “Për delegimin e kompetencave për administrimin e territorit” të lidhur midis palëve në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Qeverisjen Vendore” i ndryshuar. Kjo marrëveshje, është lidhur pa afat.

Në 3 njësitë administrative të tjera, janë evidentuar raste të ndërtimeve pa leje për të cilat nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore; nuk është aplikuar masa e gjobës, prishje të objektit pa leje ndërtimi deri në kallëzim penal, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban” i ndryshuar, konkretisht:

Në njësinë administrative **Shirgjan**, janë evidentuar 8 raste të ndërtimeve pa leje

Në njësinë administrative **Gjinar**, janë evidentuar 17 raste të ndërtimeve pa leje; për 8 prej këtyre rasteve megjithëse janë mbajtur akte konstatimi, nuk është aplikuar masa e gjobës në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe

Zhvillimin Urban”, neni 52, pika 1, germa “e”, me efekt në të ardhurat e njësisë lokale për **shumën 4,000,000 lekë.**

Në njësinë administrative **Labinot Fushë**, janë evidentuar 14 rate të ndërtimeve pa leje. Për këto raste megjithëse janë mbajtur akte konstatimi, nuk është aplikuar masa e gjobës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban”, neni 52, pika 1, germa “e”, me efekt në të ardhurat e njësisë lokale për **shumën 7,000,000 lekë.**

18.1. Rekomandimi:

IMKT-ja e Bashkisë Elbasan, të marrë masa dhe të organizojë kontrollin e territorit në të gjithë juridiksioni e vet, përfshi 12 njësitë administrative në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban” i ndryshuar, ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar”, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe VKM nr. 500, datë 14.8.2015 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi:

Në Bashkinë Elbasan, është organizuar dhe funksionon policia bashkiake me 19 punonjës, nga të cilët 7 punonjës janë me arsim të lartë dhe 12 janë me arsim të mesëm.

U konstatua se për punësimin e punonjësve të policisë, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore me konkurrim. Punonjësit e policisë, nuk kanë formim Akademik Ushtarak, në kundërshtim me kërkesat e “Rregullores së Brendshme ”Tip” të Policisë dhe Komunës”, Kreu III, neni 11, pika 5, ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 ”Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake” neni 4 i tij, si dhe ”Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003”.

19.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të procedojë sipas kërkesave ligjore për marrjen në punë të punonjësve të policisë bashkiake në përputhje dhe në zbatim të “Rregullores së Brendshme ”Tip” të Policisë dhe Komunës”, Kreu III “Marrëdhëniet e punës dhe Funksionet Organike, neni 11 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi, pika 5.

Vazhdimisht

20. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me përzgjedhje mbi procedurat ligjore për kryerjen e aktiviteteve social kulturore nga Qendra e Artit Bashkia Elbasan, u konstatua në dy projekte:

“Dita e verës 2015” për vlerën e financuar 3.000.000 lekë dhe “Vepër teatrale-komedi”, për vlerën 498.000 lekë, në shkelje të kërkesave të VKM nr. 1173, datë 6.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pa varura” kreu II, pika 2, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu VI, pika 2 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58.

20.1. Rekomandimi:

Nga Qendra e Artit e Bashkisë Elbasan, të merren masat për zbatimin e kërkesave ligjore në procedurat për kryerjen e aktiviteteve social kulturore duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për rastet e konstatuara me shkelje. Të organizohen komisionet për marrjen në dorëzim të shërbimit të kryer nga të tretët për aktivitetet social kulturore, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Vazhdimisht

21. Gjetje nga auditimi:

Për vitin 2015, Bashkia Elbasan nëpërmjet Klubit “Shumë sportet”, ka financuar 14 shoqata sportive për 72 lojtarë gjithsej si dhe 17 trajnerë. Tarifat e shpërblimit janë miratuar sipas vendimit të këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.01.2011. Nuk ka vendime të këshillit të bashkisë për miratimin e tarifave të shpërblimit të sportistëve për vitet 2014, 2015, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar nenet 15, 19.

Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 7, datë 24.01.2011, nuk është i bazuar ligjërisht pasi i referohet ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” i ndryshuar dhe VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që arrijnë këto nivele si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, të cilat përcaktojnë tarifa shpërblimi **vetëm për lojtarët** e nivelit të lartë.

Shoqatat sportive të financuara nga Klubit “Shumë sportet”, kanë përdorur objektet sportive publike (të bashkisë), por nuk janë lidhur me to marrëveshje kontraktuale, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” i ndryshuar, Kreu VIII, neni 30.

21.1. Rekomandimi:

Bashkia Elbasan, të rishikojë financimin e shoqatave sportive me qëllim për të përshtatur format financimi bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” dhe akteve të tjera nënë ligjore në zbatim të tij.

Përdorimi i objekteve sportive, të bëhet mbi bazën e marrëveshjeve kontraktuale të lidhura me shoqatat sportive, në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda Muajit Qershor 2016

22. Gjetje nga auditimi:

-Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, për arsye se: kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46, pika 1, e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për arsye se, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve.

-Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, kjo në kundërshtim me VKM “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pikat 1 dhe 3, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

22.1. Rekomandim:

Bashkia Elbasan në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, në kriteret e veçanta të veçanta të kualifikimit, të shmang vendosjen e kërkesave diskriminuese, duke mos vendosur kufizime dhe pengime të pa arsyeshme, me qëllim stimulimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të çdo operatori ekonomik që kryhen veprimtari ndërtuese, në të gjithë territorin e vendit.

Menjëherë, në vijueshmëri

23. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i ofertave të OE rezulton se KVO nuk ka zbatuar pikën 4, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të LPP, ku përcaktohet se: Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Veç kësaj KVO-ja ka përdorur dy standarde të ndryshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të operatoreve ekonomik, duke skualifikuar OE me vlerë më të ulët se ofertat fituese, gjë autoriteti kontraktor ka paguar më tepër për të njëjtën sasi mallrash, punë apo shërbimesh.

23.1.Rekomandim:

Autoriteti kontraktor duhet të forcojë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit. Konkretisht:

Në hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit, në përgatitjen, miratimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimin e transaksioneve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë

24.Gjetje nga auditimi:

-Në auditimin e procedurave të prokurimit, u konstatuan se në 8 kontrata me fond limit në vlerën 244,209 mijë lekë në vitin 2014, dhe në 5 kontrata me fond limit në vlerën 244249 mijë lekë në vitin 2015, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, **në vlerën 58,250,305 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

24.1.Rekomandimi:

Bashkia Elbasan të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomicitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 13 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike **në vlerën 58,250,305 lekë, duke** vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Menjëherë

25.Gjetje nga auditimi:

Në 23 procedura prokurimi shërbimi i kolaudimit të punimeve të zbatimit, **në vlerën 1,180,722 lekë** nuk është tenderuar, në kundërshtim me nenin 35 “Konkurs projektimi”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 38 “Konkursi i projektimit”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe DST, për arsye se, autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë ligj.

25.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan të marrë masa që shërbimi i kolaudimit të punimeve të zbatimit detyrimisht duhet të tenderohet, duke iu nënshtruar procedurave të prokurimit publik për kontrata-shërbimesh.

Menjëherë

26.Gjetje nga auditimi:

Titullari i autoritetit kontraktor ka emëruar zj.P.M. me licencë nr. MK.0004/1 date 04.07.2011, në 16 kontrata, zj. L.K. me licencë nr. MK.0068/2 date 04.06.2012, në 4 kontrata, z. S.R. me licence nr MK1443/1 date 07.11.2011, OE Zenit-06 sh.p.k/ me licencë MK 1208/6 date 15.04.2013 z. D.P. me licencë nr. MK.0856/1 date 31.03.2008, dhe z. H.Xh. me licencë nr. MK.1245/2 date 19.03.2012 përkatësisht me nga 1 kontratë, në cilësinë e mbikëqyrësve të punimeve për punimet civile, në kundërshtim me neni 7, ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i

ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, *për arsye se, mbikëqyrësit nuk kanë të gjitha kategoritë përkatëse për mbikëqyrje punimesh të përcaktuar nga autoriteti përkatës shtetëror.*

26.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan të marrë masa që shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit detyrimisht duhet të kryhet nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse profesionale për punimet e zbatimit, konform nenit 7, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

27.Gjetje nga auditimi:

Projekti i zbatimit me objekt: Rruga “Lef Nosi” në vlerën 19,840,431 lekë, Rruga e Re (bashkimi i Rr. “Rinia” me Rr. “28 Nëntori”) në vlerën 12,083.314 lekë, Sis-asfaltim i rrugëve “H Bakalli” & “A Zyma” 97,965,296 Sis-asfaltim i Rr. “Q Stafa” Loti 1–4 në vlerën 298,472,227 lekë, Suvatim lysterje fasadash (bul.”Aqif Pasha” & Rr. “Q. Stafa”) në vlerën 48,947,039 lekë, F.V ndriçues rrugor (bul. “A Pasha”, Rr. “Q. Stafa”, Rr. “Th. Kalefi”) në vlerën 43,189,259 lekë, Suvatim & lysterje fasadash 100 banesa kolektive në vlerën 137,148,424 lekë, Sis, asfaltim i sheshit “Esat Bordi” në vlerën 37,396,878 lekë, Sis-asfaltim i Rr. “N. Kokobobo” & sheshet e pallateve në vlerën 42,823,981 lekë, Sis-asfaltim i Rr. “M. Dharmo” & sheshet e pallateve në vlerën 23,985,874 lekë, KUZ (Rr. “A. Mezini”, “Shën Thanasi”) L.”E Matraxhiu” në vlerën 6,616,776 lekë, janë hartuar në kundërshtim me nenin 5, kreu III Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit neni, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për arsye se punonjësit të cilët kanë hartuar Projektin e Zbatimit nuk kanë licencat përkatëse sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale.

27.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan të marrë masa që Projekti Zbatimit, Raporti Teknik, Specifikimet dhe Preventivi detyrimisht duhet të hartohen nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse konformë nenit 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

28.Gjetje nga auditimi:

Projekti i zbatimit me objekt: “Sistemim asfaltim i Rr. “Q Stafa” Loti 1–4, në vlerën 298,472,227 lekë dhe “Suvatim, lysterje fasadash 100 banesa kolektive” në vlerën 137,148,424 lekë, nuk i janë nënshtruar oponencës teknike konform nenit 6, të ligjit nr. 8402, datë 18.7.2002 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pikës 2, 4 të vendimit nr. 1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” dhe Urdhrit Nr. 7, datë 20.01.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

28.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, të marrë masa për të kryer oponencën teknike të projekteve teknike për secilin objekt me fond limit mbi 100 milion lekë, në zbatim të ligjit me synim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve.

Menjëherë

29.Gjetje nga auditimi:

-Autoriteti kontraktor në 22 raste në vitin 2014 ka përdorur procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me fond limit 23,615 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 23,615 mijë lekë me një kursim në vlerë relative 0 % nga rreth 15% kurim në procedurat e hapura.

-Autoriteti kontraktor në 30 raste në vitin 2015 ka përdorur procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me fond limit 52,603 mijë lekë dhe vlerë të kontraktuar 52,394 mijë lekë me një kursim në vlerë absolute -209 mijë lekë ose 0.4 % nga rreth 4.6% kurim në procedurat e hapura.

29.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, të përdorin vetëm për raste të veçanta procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për arsye se me ndjekjen e zbatimit të kësaj procedure dhe në mungesë të konkurrencës autoriteti kontraktor ka paguar më tepër fonde se në procedurat e hapura ose kërkesë për propozim për rrjedhojë procedurat e prokurimit me negociim janë jo efektive.

Vazhdimisht

30.Gjetje nga auditimi:

Autoriteti kontraktor ka anuluar procedurat e prokurimit publik në 4 raste me fond limit 45,258 mijë lekë në vitin 2014 dhe 13 raste me fond limit 112,037 mijë lekë në vitin 2015, sepse operatorët ekonomikë nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit.

30.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan të analizojë rastet e anulimeve të procedurave të prokurimit dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ndaj anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pasi shkaqet më kryesore të anulimeve janë për arsye të vendosjes së kriterëve kualifikues të paargumentuara ligjërisht.

Menjëherë

31.Gjetje nga auditimi:

Në mbështetje të pikës 3 të Urdhrit të Ministrit të Financave, në të cilën përcaktohet që: “Në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të qeverisjes së përgjithshme të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë”, duhet të ishte hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila do të përbëjë një bazë të hapave dhe procedurave që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e Bashkisë në këtë proces.

31.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan (Drejtoria e Prokurimit Publik) të marrin masa për hartimin e gjurmëve të detajuara të auditimit për prokurimet publike dhe ta paraqesë te nëpunësi autorizues për miratim.

Brenda muajit Shtator 2016

32.Gjetje nga auditimi:

Në auditimin e procedurave të prokurimit në vitin 2014, u konstatuan se në 1 kontratë me vlerën 1,417,677 lekë, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, **në vlerën 135,218 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

32.1.Rekomandimi:

Bashkia Elbasan të analizojë duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomicitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 1 rast me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **135,218 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

33.Gjetje nga auditimi:

Konvertimi i tokës bujqësore “arë” në tokë “truall”, në lejen zhvillimore ndërtimi nr. 29, date 04.02.2015 nuk është bërë sipas procedurave ligjore të legjislacionit në fuqi.

Referuar ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, ndryshimi i tokave bujqësore të kategorive nga V deri në X të bonitetit në kategori të resurseve të tjera, si tokë urbane (truall ...).

33.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, të marrë masa për ndryshimin e tokave bujqësore të kategorive nga V deri në X të bonitetit në kategori të resurseve të tjera, si tokë urbane (truall) në zbatim të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

Brenda muajit Shtator 2016

34.Gjetje nga auditimi:

Në auditimin e procedurave të prokurimit në vitin 2014, u konstatua se në 1 kontrata me vlerën 1,696,719 lekë, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, **në vlerën 298,197 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

34.1.Rekomandimi:

Bashkia Elbasan të analizojë duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomicitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 1 rast me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **298,197 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

35.Gjetja nga auditimi:

-Drejtoria e Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit nuk ka ushtruar kontroll në fazën e ngritjes së kantierit të punimeve, përfshirë dhe rrethimin e përkohshëm.

-Drejtoria e Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit nuk ka ushtruar kontroll në fazën e përfundimit të themeleve.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzim nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

-Në një rast u konstatua se subjekti i ndërtimit ka shkelur kondicionet urbane duke dalë **45.5 m²** jashtë projektit të miratuar. Për këtë shkelje me vendimin Nr. 9, datë 27.11.2015, ka ndëshkuar subjektin ndërtues “B...” me shumën 1,500,000 lekë. Kjo tregon se nuk janë kryer aktet e kontrollit efektive nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban, për vitet 2014, 2015, që vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit si, por jo vetëm, për themelin, karabinanë, punimet mekanike, hidraulike, të izolimit, rifiniturave dhe të sistemimeve të jashtme, në kundërshtim me, seksioni VI, neni 79 “Leja e përdorimit” e ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 ‘Për planifikimin e territorit’ dhe pikën 2, neni 38, të VKM Nr. 502, datë 13.07.2011 për “Miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”.

35.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, (Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban) të kryej kontrolle efektive që vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit, për themelin, karabinanë, punimet mekanike, hidraulike, të izolimit, rifiniturave dhe për rastin e cituar më sipër të zbatohen dispozita të fushës së planifikimit të territorit.

36.Gjetje nga auditimi:

-Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban nuk ka informacion në lidhje me subjektet të cilave i ka kaluar afati i lejes së ndërtimit dhe nuk janë pasur me leje shfrytëzimi.

-Bashkia Elbasan, nuk ka pasqyra të përditësuara në lidhje me lejet e ndërtimit dhe lejet e përdorimit të dhëna në vite, me të dhëna të domosdoshme për verifikimin zbatimit të kushteve mbi të cilat është dhënë leja, në mënyrë të veçanët afati i përcaktuar në lejen e ndërtimit për ndërtimin e objektit dhe marrjen e lejes së përdorimit, për rrjedhojë Bashkia Elbasan nuk aplikon taksat mbi pasurinë e paluajtshme sipas Tabela – A Taksa e Pasurive të paluajtshme për ndërtesat.

36.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, (Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban) të hartojë DATA BAZE të përditësuara në lidhje me dhënien e lejeve të ndërtimit të dhëna ndër vite të cilave u ka kaluar afati i zbatimit dhe nuk janë pajisur me leje përdorimi, duke verifikuar kushtet e zbatimit dhe aplikimin e taksave mbi pasuritë e paluajtshme sipas vendimeve të Këshillit Bashkisë.

Brenda muajit Shtator 2016**37.Gjetje nga auditimi:**

Bashkia Elbasan, nuk ka një regjistër të regjistrimit të faturave të lëshuara nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban në lidhje me shërbimet e kryera (Tabela – C – Taksa e ndikimit në infrastrukture Strukture banimi 3% e investimit, Strukture me funksion shërbimi e administrative 3% e investimit, Strukture për qëllime publike 2% e investimit, Vendosje antenash (Konstruksion metalik) 3% e investimit, Rehabilitim rrugësh, ujësjellës - kanalizime 2% e investimit, Vendosje reklama e promocion(private e publike 3% e investimit, Çdo kantier ndërtimi për objekt mbi 4 kate lek/vit 100,000 lekë, Çdo objekt ndërtimi nën 4 kate lek/vit 30000 lekë, Për ndryshim destinacioni lek/vit 5000 lekë, Rikonstruksione e struktura të ndryshme lek/vit 5000 lekë), në cilësinë e strukturës për vjeljen e këtyre taksave.

37.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan, të hartojë një regjistër të regjistrimit të faturave në lidhje me shërbimet e kryera nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban, në cilësinë e strukturës së ngarkuar për vjeljen e këtyre taksave me vendimet e Këshillit Bashkisë.

Brenda muajit Shtator 2016**38.Gjetje nga auditimi:**

Bashkia Elbasan, nuk ka hartuar planin rregullues të territorit që administrojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, kreu II “instrumentet e planifikimit të territorit”, Seksioni I “llojet e instrumenteve të planifikimit të territorit”, nenet 20, 21, 22.

-nuk ka miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT) në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) Planin e Detajuar Vendor dhe Planin të Përgjithshëm Vendor.

38.1.Rekomandimi:

Bashkia Elbasan nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit Urban, të marrë masa për përshtatjen e planit vendor, që ka mbetur në proces miratimi, me rregulloret uniforme dhe dispozitat e këtij ligji, për të bërë të mundur miratimin e planit të përgjithshëm vendor (PPV) ose planin e përdorimit të tokës (PPT).

Brenda muajit Shtator 2016**39.Gjetje nga auditimi:**

Pezullimin i lejes së ndërtimit me shkresën nr. 3407 Prot., datë 13.11.2012, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës së urbanistikës për rrjedhojë duhet të revokohet nga bashkia Elbasan, pasi sipas dispozitave të fushës nuk mund të jepet një leje ndërtimi me kusht.

39.1.Rekomandim:

Bashkia Elbasan të revokojë shkresën nr. 3407 prot., datë 13.11.2012 me objekt "Pezullimin e lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin e KRRT nr. 02, datë 05.04.2012".

Menjëherë

40.Gjetje nga auditimi:

Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan, rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4, paragrafi.

40.1.Rekomandim:

Zyra e Planifikimit të Territorit, bashkia Elbasan, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"; Kreu V, nenet 9-14 dhe Kreu VII-të- Funkioni dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 50,277,319**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me 50 ditë në kontratën me objekt "Loti 2: Sistemim – asfaltim i rrugës "Qemal Stafa", segmenti nga kryqëzimi i rrugës "Rinia" deri tek kryqëzimi me rrugën "Kasem Sejдини" si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit "Aqif Pasha" dhe rrugës "Qemal Stafa", është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se "afati për mbarimin e punimeve është 90 ditë pas lidhjes së kontratës", duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 15,254,310 lekë** (penalitet i përlogaritur 76,271,551 lekë x 4/1000 x 50 ditë) të arkëtueshëm nga operatori ekonomik **V.I.**

1.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **15,254,310 lekë**, nga operatori ekonomik **V.I.** sh.p.k, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve për vonesën e dorëzimit të objektit: "Loti 2: Sistemim – asfaltim i rrugës "Qemal Stafa", segmenti nga kryqëzimi i rrugës "Rinia" deri tek kryqëzimi me rrugën "Kasem Sejдини" si dhe i rrugëve lidhëse ndërmjet bulevardit "Aqif Pasha" dhe rrugës "Qemal Stafa".

2. Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me 60 ditë në kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve te pallateve nr. 60, 61, 62 63/1, 64/3, lagjja Emin Matraxhiu, Elbasan”, është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se “afati për mbarimin e punimeve është 60 ditë pas lidhjes së kontratës”, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 8,395,833 lekë** (penaliteti i përlogaritur 34,982,638 lekë x 4/1000 x 60 ditë) të arkëtueshëm nga BOE BE-IS sh.p.k & A.K. sh.p.k.

2.1. Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **8,395,833 lekë**, nga bashkimi i operatoreve ekonomik “B...” shpk & “A...” sh.p.k e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve te pallateve nr. 60, 61, 62 63/1, 64/3, lagjja Emin Matraxhiu, Elbasan”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Zhvillimit të Territorit Urban nuk ka kryer rillogaritjen e vlerës së investimit në të gjitha procedurat e dhënies së lejeve të përdorimit sipas çmimeve për njëjësi të përcaktuara në manualin e punimeve të ndërtimit. Nga përlogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës për studim projektim për vitin 2014, rezultoi se 24 subjekte kanë paguar më pak **në vlerën 3,586,578 lekë**, ndërsa në vitin 2015, rezultoi se 26 subjekte kanë paguar më pak **në vlerën 4,086,767 lekë**, vlera të përlogaritura përlogaritur në bazë të treguesve të sipërfaqes së ndërtimit, çmimin për njësi të përcaktuar në manualin e çmimeve, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën për studim projekte, *më hollësisht shih tabelën “Leje përdorimi 2014” dhe “Leje përdorimi 2015”, bashkëlidhur.*

3.1. Rekomandim:

Bashkia Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 7,673,345 lekë**, nga kërkuesit e lejeve të përdorimit sipas Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur, për arsye se, vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur, duke u bazuar në manualin teknik të çmimit të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM-në përkatëse.

Brenda Muajit Shtator 2016

4. Gjetje nga auditimi:

Në objektin: “Rikonstruksioni i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kamber Sejdi” si dhe i rrugëve lidhëse midis bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa” loti II”, Bashkia Elbasan, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **6,142,728 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pikat 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe operatorit ekonomik “V.I.” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimit nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

4.1. Rekomandim:

Nga Bashkia Elbasan, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,142,728 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “V.I.” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. - Prot., datë 11.07.2014 me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kamber Sejдини” si dhe i rrugëve lidhëse midis bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa” loti II”, Bashkia Elbasan, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda Muajit Shtator 2016

5. Gjetje nga auditimi:

Në Njësinë Administrative Bradashesh, janë në fuqi katër kontrata për dhënien me qira të trojeve Subjekteve të telefonisë celulare.

Nga këto subjekte, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale për periudhën deri 31.12.2015 vlerën totale **3,250,000 lekë, me dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil” i ndryshuar neni 850.

5.1. Rekomandimi:

Të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, arkëtimi i vlerës 3,250,000 lekë nga subjektet:

- “E...Mobile” sha për 450,000 lekë,
- “A...” sha për 700,000 lekë,
- “V...” sha për 900,000 lekë,
- “M...” sha për 1,200,000 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Është respektuar struktura organizative dhe niveli i pagave sipas miratimit me vendim të këshillit të bashkisë.

Për vitet 2014 dhe 2015, janë paguar anëtarë të këshillit të bashkisë pa marrë pjesë në mbledhje për vlerën **2,657,507 lekë me dëm ekonomik** nga të cilat; në vitin 2014 për 37 anëtarë të këshillit në vlerën 1,297,764 lekë, në 6-mujorin e parë të vitit 2015 për 36 këshilltarë në vlerën 1,201,002 lekë dhe 6-mujori dytë të vitit 2015 për 11 këshilltarë në vlerën 158,741 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 29, pika 2.

Në këto raste, nga institucioni është aplikua ndalesë vetëm 500 lekë për çdo rast mungesë pjesëmarrje në mbledhje, pa e argumentuar ligjërisht.

6.1. Rekomandimi:

Të procedohet sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga personat përfitues, ish anëtarë të këshillit të bashkisë, të shumës 2,657,507 lekë për sa janë shpërblyer në kundërshtim me kërkesat ligjore, sipas listës emërore bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda Muajit Shtator 2016

7. Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me 50 ditë në kontratën me objekt: Rruga "Lef Nosi" (vazhdim i rrugës deri në bashkimin me Unazën Veriore) Lagja 5 Maji”, është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikonin e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se “afati për mbarimin e punimeve është 45 ditë pas lidhjes së kontratës” duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 2,660,000 lekë** (penalitet i përlllogaritur 13,300,000 lekë x 4/1000 x 50 ditë) të arkëtueshëm nga OE “B...” sh.p.k. sh.p.k.

7.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,660,000 lekë**, nga operatori ekonomik “B...” sh.p.k. e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt "Lef Nosi" (vazhdim i rrugës deri ne bashkimin me Unazën Veriore) Lagja 5 Maji”.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me mbi 83 ditë është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se “afati për mbarimin e punimeve është 25 ditë pas lidhjes së kontratës”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **759,086 lekë** (penalitet i llogaritur $2,286,406 \times 83 \times 4/1000$), të arkëtueshëm nga OE “S...&L...”.

8.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **759,086 lekë**, nga operatori ekonomik, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm rrugor në Komunën Gjinar”.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me 10 ditë në kontratën me objekt: “Ndërtim i rrugës "Sheqet Daiu", Unaza Veriore, Segmenti A-B, lagja "11 Nëntori”, është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se “afati për mbarimin e punimeve është 55 ditë pas lidhjes së kontratës”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **676,964 lekë** (penalitet i llogaritur $16,924,094 \text{ lekë} \times 4/1000 \times 10 \text{ ditë}$) të arkëtueshëm nga operatori ekonomik “B...” sh.p.k.

9.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **676,964 lekë**, nga operatori ekonomik “B...” sh.p.k, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt “Ndërtim i rrugës "Sheqet Daiu", Unaza Veriore, Segmenti A-B, lagja "11 Nëntori”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Nga ish Komunën Funarë, me fletë daljen nr. 01, datë 27.03.2014, janë bërë dalje tavolina dhe karrige për nxënësit e “Shkollës së Mesme të Bashkuar Ibrahim Bozhiqi” të ish komunës Labinot-Mal për vlerën neto **412,888 lekë**. Fletë dalja është firmosur nga drejtori i shkollës z. Ismail Alushi.

Nga dokumentacioni i paraqitur në Bashkinë Elbasan, rezulton se këto materiale nuk janë bërë hyrje.

Nga ish Komunën Funarë, me fletë daljen nr. 02, datë 27.03.2014, janë bërë dalje tavolina dhe karrige për nxënësit e “Shkollës Mesme Bashkuar 11 Dëshmorët” të ish komunës Labinot-Mal për vlerën neto **103,970 lekë**. Fletë dalja është firmosur nga drejtori i shkollës.

Nga dokumentacioni i paraqitur në Bashkinë Elbasan, rezulton se këto materiale nuk janë bërë hyrje.

Nga ish Komunën Funarë, me fletë daljen nr. 03, datë 27.03.2014, janë bërë dalje tavolina dhe karrige për nxënësit e shkollës “Grigan i sipërm të Komunës Labinot Fushë” të ish

komunës Labinot-Fushë për vlerën neto **101,297 lekë**. Fletë dalja është firmosur nga drejtoresha.

Nga dokumentacioni i paraqitur në Bashkinë Elbasan, rezulton se këto materiale nuk janë bërë hyrje.

Veprimet e mësipërme të lëvizjes dhe inventarizimit të vlerave inventariale, janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, me pasojë mungesa në evidencat e inventareve ekonomike për shumën **618,155 lekë me dëm ekonomik**, në ngarkim të personave që i kanë marrë në ngarkim.

10.1. Rekomandimi:

Të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, arkëtimi i vlerës **618,155 lekë** për subjektet:

-I.A. për 412,888 lekë,

-Q.B. për 103,970 lekë,

-B.H. për 103,297 lekë.

Brenda Muajit Shtator 2016

11. Gjetje nga auditimi:

Në procedurën me vlerë të vogël e zhvilluar me objekt:

-“Riparim i rrugëve të komunës Shirgjan”, me fond limit 649 865 lekë pa tvsh, zhvilluar më datën 03.04.2015, komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël kanë skualifikuar operatorët ekonomik në kundërshtim me LPP, RrPP dhe udhëzimet e APP-së duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 263,495 lekë**,

-“Shërbime e mirëmbajtje kanale kulluese, më fond limit 199 856 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 20.04.2015, komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël kanë skualifikuar, në kundërshtim me LPP dhe RrPP dhe UAPP, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 19,000 lekë**.

- “Riparim i rrugëve të komunës Shirgjan” me fond limit 772,200 lekë me tvsh, zhvilluar 25.06.2015, komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël ka skualifikuar për mosplotësim të kriterëve për kualifikim operatorët ekonomik, në kundërshtim me dispozitat e fushës së prokurimit publik gjë që ka shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 207,000 lekë**, pasi në këtë fazë ofertuesit përfshij edhe operatorin ekonomik fitues nuk janë të detyruar të hedhin në sistem dokumentacionin administrativo –ligjor.

11.1.Rekomandim:

Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik **në vlerën 489,495 lekë**, nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në mënyrë solidarë secili nga 163165 lekë, respektivisht: nga z. M.C, z. D.C dhe z. A.P, për arsye se, në cilësinë e anëtarëve të KPVV, kanë s`kualifikuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e prokurimeve publike për arsye se, në këtë fazë asnjë operator ekonomik përfshi edhe ofertuesin e shpallur fitues nuk kanë paraqitur në sistem dokumentet e pranimit kualifikimit.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi:

Në Njësinë Administrative Shushicë, janë në fuqi katër kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore me afat 99 vjet gjithsej për 14,614 ha tokë. Për një subjekt nuk janë paguar detyrimet kontraktuale për periudhën deri datë 31.12.2015 për vlerën 103,757 lekë.

Për veç kësaj janë lidhur edhe 4 kontrata me kompanitë e telefonisë celulare për dhënien e trojeve me qira me afat 9 vjeçar për sipërfaqen gjithsej 800 m². Për një subjekt, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale për periudhën deri datë 21.12.2015 për vlerën 345,224 lekë.

Detyrimi i pa paguar nga këto dy subjekte për vlerën **448,981 lekë përbën dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850.

12.1. Rekomandimi:

Të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, arkëtimi i vlerës 448,981 lekë për subjektet:

- V.B. për 103,757 lekë,
- Subjekti A... sha për 345,224 lekë.

Brenda Muajit Shtator 2016

13. Gjetje nga auditimi:

Në Njësinë Administrative Gjergjan, janë në fuqi dy kontrata për dhënie me qira për dy personave fizikë, të tokës bujqësore me sipërfaqe 17,5295 ha, me afat 99 vjet dhe për subjektin "AMC" sha të sipërfaqes 300 m² truall me afat 9 vjet.

Nga këto subjekte, nuk janë paguar të gjitha detyrimet kontraktuale në shumën totale **387,414 lekë, me dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850.

13.1. Rekomandimi:

Të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, arkëtimi i vlerës 387,414 lekë për subjektet:

- A.Xh. për 40,656 lekë,
- F.R. për 40,656 lekë,
- Subjekti A... sha për 304,102 lekë.

Brenda Muajit Shtator 2016

14. Gjetje nga auditimi:

Zgjatja e afatit të zbatimit të punimeve me 10 ditë në kontratën me objekt "Ndërtim i rrugës së re nga kryqëzimi i rrugës "28 Nëntori" deri në kryqëzimin e rrugës "Rinia", është në kundërshtim me Formularin e Njoftimit të Kontratës, Grafikun e Punimeve (DST) dhe ofertën e operatorit ekonomik në të cilin përcaktohet se "afati për mbarimin e punimeve është 45 ditë pas lidhjes së kontratës", duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 302,222 lekë** (penalitet i llogaritur 7,555,555 leke x 4/1000 x 10 ditë) të arkëtueshëm nga operatori ekonomik "S..." sh.p.k.

14.1. Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **302,222 lekë**, nga operatori ekonomik, e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penalitetëve, në tenderin me objekt "Ndërtim i rrugës së re nga kryqëzimi i rrugës "28 Nëntori" deri në kryqëzimin e rrugës "Rinia".

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi:

Nga Bashkia Elbasan, janë lidhur 8 kontrata qiradhënie të objekteve ndërtimore me sipërfaqe totale 445,12 m².

U konstatua se nuk janë paguar detyrimet kontraktore për 7 subjekte **në shumën 152,304 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë.

15.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Aseteve Pronave dhe Strehimit, të marrë masa të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte të shumës 152,304 lekë, në zbatim të kushteve të kontratës të lidhur midis palëve.

Brenda Muajit Shtator 2016

16. Gjetje nga auditimi:

Preventivi i objektit “Rruga Europa, ish Uzina 12, Rruga Harvales ...”, është hartuar në kundërshtim me manualin teknik të çmimeve në fuqi dhe pikat 2, 3 dhe 9 të VKM Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 101,490 lekë** të arkëtueshëm nga OE “B...”.

16.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **101,490 lekë**, nga operatori ekonomik “B...” shpk e cila përfaqëson diferencën ndërmjet manualit dhe çmimeve në preventivit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi:

Nga Bashkia Elbasan, janë lidhur me të tretët 8 kontrata qiradhënie për objektet ndërtimore për vlerë të sipërfaqes nën 200 m².

U konstatua se nuk janë paguar detyrimet kontraktore për 2 subjekte **në shumën 91,124 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e bashkisë Elbasan.

17.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve, të marrë masa për arkëtimin nga 2 subjekte të shumës **91,124 lekë** sipas kushteve të kontratave për dhënien me qira.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi:

Ndryshimi i preventivit në zërin “Hapje çakulli në rrugë dhe ngjeshje me makineri” nga 15000 m² në 16794 m² **ose 1794 m² më tepër** në objektin “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm rrugor në Komunën Gjinar”, është në kundërshtim me projektin e zbatimit, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 87,906 lekë**, të arkëtueshëm nga OE “S...&L...”.

18.1.Rekomandim:

Të merren masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **87,906 lekë**, nga operatori ekonomik “S...&L...” e cila përfaqëson diferencën në preventivit në zërin “Hapje çakulli në rrugë dhe ngjeshje me makineri” nga 15000 m² në 16794 m² **ose 1794 m² më tepër**.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi:

Në Njësinë Administrative Papër, është në fuqi një kontratë për dhënien me qira të tokës bujqësore me sipërfaqe 10,7 ha, me afat 99 vjet për personin fizik Shkëlqim Bullari. Nga këto subjekte, nuk është paguar detyrimi i kontratës për vitin 2015 në vlerën **69,757 lekë, me dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin Civil” i ndryshuar neni 850.

19.1. Rekomandimi:

Të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, arkëtimi i vlerës **69,757 lekë** nga subjekti SH.B.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi:

Janë bërë shpenzime karburanti për dy auto vetura të administratës së bashkisë; 326,5 litra për **vlerën 57,098 lekë** të pa justifikuara me dokumentacionin e nevojshëm ligjor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12 si dhe UMF nr. nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar neni 36.

20.1. Rekomandimi:

Të bëhet kontabilizimi dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **57,098** lekë nga 9 punonjësit përgjegjës si më poshtë;

1-XH.F. për vlerën	7,277 lekë
2- H.H. për vlerën	12,250 lekë
3- M.K. për vlerën	5,988 lekë
4- G.R. për vlerën	5,988 lekë
5- I.C. për vlerën	9,880 lekë
5- S.F. për vlerën	14,970 lekë
6- S.A. për vlerën	373 lekë
7- F.M. për vlerë	372 lekë

Brenda Muajit Shtator 2016

21. Gjetje nga auditimi:

Me urdhër shpenzim nr. 298, datë 26.05.2015 është paguar personi fizik G.S. për vlerën 9,600 lekë për shërbime të kryera sipas procedurave për blerje dhe shërbime me vlera të vogla. Është paguar më tepër se sa oferta e paraqitur **për vlerën 1,600 lekë**, në kundërshtim me kërkesa e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik“ i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ i ndryshuar.

21.1.Rekomandimi:

Të bëhet kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,600** lekë nga personi fizik G.S.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C/1.Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore” dhe 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe në nenin 64 gerrat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Titullarit pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, Bashkisë Elbasan t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, të klasifikojë shkeljet e konstatuara, në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masave disiplinore, nga masa “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Statusin e Nëpunësit Civil, për 2 punonjësit si më poshtë:

1. Z. R.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban:

-Nuk ka kryer rillogaritjen e vlerës së investimit në të gjitha procedurat e dhënies së lejeve të përdorimit sipas çmimeve për njëjësi të përcaktuara në manualin e punimeve të ndërtimit. Nga përlllogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe tarifës për studim projektim për vitin 2014, rezultoi se 24 subjekte kanë paguar më pak **në vlerën 3,586,578 lekë**, ndërsa në vitin 2015, rezultoi se 26 subjekte kanë paguar më pak **në vlerën 4,086,767 lekë**, vlera të përlllogaritura përlllogaritur në bazë të treguesve të sipërfaqes së ndërtimit, çmimin për njësi të përcaktuar në manualin e çmimeve, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën për studim projekte.

2.Zj. O.D. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike:

-Për sa nuk ka ndjekur procedurat ligjore duke bërë kërkesë padi në Gjykatë për shpërblimin e dëmit në vlerën 30,346,525 lekë për 12 rekomandime të KLSH-së, të kërkuara nga auditimi i kaluar me shkresën nr. 307/7 prot., datë 30.6.2014, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 8, ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", nenet 105-109 dhe ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

C/2 .Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronja "e" dhe "ç" të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neneve 11 dhe 12, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore "Vërejtje" deri në "Zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës", për 5 punonjës si më poshtë:

1. Z. L.K. me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit:

-Për sa nuk ka ushtruar funksionet e tij për Mbrojtjen dhe Kontrollin e Territorit në 12 ish komuna sot njësi administrative të Bashkisë Elbasan: Zavalinë, Gjergjan, Papër, Bradashesh, Labinot-Mal, Labinot-Fushë, Tregan, Shushicë, Shirgjan, Gjinar, Grecan dhe Funar.

-Nuk ka programuar e ushtruar kontrole si dhe nuk ka marrë informacione nga administratorët e këtyre njësive mbi gjendjen e territorit lidhur me ndërtimet pa leje sipas konstatimeve të Kryeinspektorëve të Inspektorateve të Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit të ish komunave, mosveprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin Urban" i ndryshuar, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial", Kreu III, pika 1.

-Në 52 raste të vendimeve për prishje të objektit pa leje ndërtimi, nuk është marrë vendimi për të detyruar subjektin kundërvajtës për kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban" i ndryshuar, neni 52, pika 6.

-Në 26 raste, është aplikuar masa e gjobës ndaj subjektit kundërvajtës, në vlerë më të vogël se sa është parashikuar në kërkesat ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin Urban", neni 52, pika 1, germa "e".

2. Zj. A.J. me detyrë ish specialiste e Sektorit të Strehimit Drejtoria e Menaxhimit të Aseteve e Prokurimeve Publike për periudhën 15.7.2015 deri 22.09.2015 dhe Drejtore e Drejtorisë së Aseteve Pronave e Strehimit për periudhën 22.09.2015 e në vazhdim:

-Për sa nuk ka ushtruar funksionet e veta lidhur me administrimin e aseteve në 12 ish komuna sot njësi administrative të Bashkisë Elbasan: Zavalinë, Gjergjan, Papër,

Bradashesh, Labinot-Mal, Labinot-Fushë, Tregan, Shushicë, Shirgjan, Gjinar, Grecan dhe Funar.

Drejtorja e Aseteve, Pronave e Strehimit, nuk disponon të dhënat e nevojshme mbi gjendjen dhe administrimin e pronave të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi ose në përdorim të 12 ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan me qëllim, vënien në efikasitet për interesin publik.

-Nuk disponon të dhënat e nevojshme mbi vendime të këshillave të ish komunave mbi asetet, nëse i kanë pranuar ose jo në pronësi, nëse janë kryer procedurat e nevojshme për regjistrimin në ZVRPP në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore.

-Nuk disponon të dhëna mbi kontrata për dhënien me qira të aseteve të lidhura nga ish komunat dhe menaxhimin e tyre, në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM Nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pikat 20, 21, 22, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pikat 37, 42-60, 74, ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, kreu IV, neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për Fondin kullor”, i ndryshuar, neni 18 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

3. Z. K.K. me detyrë Drejtor i Qendrës së Artit, i cili nuk ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim të shërbimit të aktivitetit social kulturor “Dita e verës 2015” të zhvilluar sipas Urdhrit me nr. 1, datë 3.03.2015, me fond limit 3,000,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu VI, pika 2 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58.

4. Z. I.S. me detyrë Drejtor i Teatrit “Skampa” në cilësinë e kryetarit të komisionit për procedurat e aktivitetit artistik- kulturor “Dita e verës 2015”, të kryer sipas urdhrat të titullarit nr. 1, datë 3.03.2015:

-Për sa procedurat e prokurimit, janë të pa rregullta, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 6.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pa varura” kreu II, pikat 2-8.

5. Z. Y.S. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës, në Qendrën e Artit:

-Për sa është paguar subjekti: “D...” shpk me NIP K 72210003 J në shumën 3.000.000 lekë, për shërbimin e aktivitetit social -kulturor “Dita e verës 2015” dhe Shoqata Kulturore “PCC” me NIPT L 32818392 VV për shumën 498.000 lekë për kryerjen në vitin 2014, të aktivitetit social kulturor “Vepër teatrale-komedi”, pa pasur akt marrje në dorëzim të shërbimeve, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu VI, pika 2 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar nenet 35/b, 42, 43, 47, 52, 58.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.1. Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Elbasan, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ***i kërkojmë Titullarit të Autoritetit Kontraktor (Kryetarit të Bashkisë Elbasan)***, që në zbatim të pikës 2, të nenit 72 “Kundërvajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 81 “Masat disiplinore”, Kreu XI “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj 13 ***anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe specialistëve të Njesisë së Prokurimit sipas përgjegjësiwe përkatëse në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht:***

1. **zj. A.B.** me detyrë Drejtor Prokurimeve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
2. **zj. A.P.** me detyrë N/Kryetar, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
3. **z. K.XH.** me detyrë N/Kryetar, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
4. **z. I.S.** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
5. **z. M.D.** me detyrë Supervisor Gjellbërimit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
6. **z. Y.K.** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
7. **zj. A.M.** me detyrë P/Sek. Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për arsye se:

Kanë skualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin, ekonomik, financiar dhe teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit operatorë ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër kanë kualifikuar dhe shpallur fitues operator ekonomik kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST (Kriteret e Veçanta të Kualifikimit), nenin 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreun V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Kreun VII, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

8. **z. O.K.** me detyrë Specialist i Prokurimeve, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit,
9. **z. L.I.** me detyrë Specialist i Prokurimeve, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit,
10. **z. A.E.** me detyrë P/Sekt. të Prokurimeve, në cilësinë e Specialistit në Njesisë e Prokurimit,
11. **z. I.B.** me detyrë Specialist i Prokurimeve, në cilësinë e Specialistit në Njesisë e Prokurimit,
12. **zj. A.B.** me detyrë Specialist i Prokurimeve, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit,
13. **zj. A.S.** me detyrë P/Sek. Pronave, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit.

Për arsye se:

-Nuk kanë dhënë argumente të hollësishme mbi arsyet e vendosjes së çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me kreun III “Dokumentet e tenderit”, të miratuara me Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kriteret jo përpjesëtimore e të ekzagjeruar kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, mallrave dhe shërbimeve, për rrjedhojë autoriteti kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe përzgjedhjen e ofertuesit fitues, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimeve.

D.2. Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Elbasan, të marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, të vendosë masa administrative me gjobë, për 14 persona si më poshtë:

1. **z. N.M**, me detyrë Topograf, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
2. **z. S.R**, Sp/Sek. Urb. Ligjore e Lejeve të Përdorimit, Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
3. **zj. E.Q**, me detyrë Sp/Sekt. Prokurimeve dhe Standardeve, Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
4. **z. K.B**, me detyrë Sp. Inxhinier Elektrik, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
5. **z. E.B**, me detyrë Sp/Sek. Transp. Inxhinier Mekanik, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
6. **z. D.SH**, me detyrë Sp/Sek. Mbrojta mjedisit, Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
7. **zj. E.S**, me detyrë Perp./Sekt.Proj. Standardeve, Inxhinier Hidroteknik, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
8. **zj. M.C**, me detyrë Sp. Urb. Rajonin Nr. 5 & 6, Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
9. **z. A.M**, me detyrë Inxhinier Elektrik, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit
10. **z. Gentian Tabaku**, me detyrë Dr/Projekt Standardeve, Arkitekt, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
11. **z. R.B**, me detyrë Sp/Sekt. Proj. Standardeve, Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
12. **zj. SH.SH**, me detyrë Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
13. **z. E.Zh**, me detyrë Inxhinier Ndërtimi, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit,
14. **z. M.G.**, me detyrë P/Projekt.Stand. Azhrn. Tokave, Topograf, në cilësinë e hartuesit të Projekt zbatimit.

Për arsye se:

Nuk kanë kategoritë përkatëse në licencat profesionale sipas përcaktimeve të rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për hartimin e Projekt zbatimit, kjo në kundërshtim me nenin 5, kreu III “Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve të ndërtimit” neni, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në

fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit të ndërtimit“.

D.3. Nga Bashkia Elbasan, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 200,000 lekë për Ing. L.H.** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës mbikëqyrëse të punimeve BOE “C...”sh.p.k dhe “E...” sh.p.k.

Për arsye se:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kamber Sejdiu” si dhe i rrugëve lidhëse midis bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa” loti II”, Bashkia Elbasan, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **6,142,728 lekë pa t.v.sh.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

D.4. Nga Bashkia Elbasan të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 100,000 lekë për ing. P.M,** nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve.

Për arsye se:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me: “Rikonstruksioni i rrugës “Qemal Stafa”, segmenti nga kryqëzimi me rrugën “Rinia” deri tek kryqëzimi me rrugën “Kamber Sejdiu” si dhe i rrugëve lidhëse midis bulevardit “Aqif Pasha” dhe rrugës “Qemal Stafa” loti II”, Bashkia Elbasan, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **6,142,728 lekë pa t.v.sh.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R